



Dalës-izleazna

Nr. 1-07  
Br.

Data 23.01.2019  
Datum

OBILIQ-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI<sup>15</sup>, mbledhja e 1) me dt.31.01.2019 (e enjte) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

## R E N D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Planit të Punës të Kuvendit komunal për vitin 2019
4. Shqyrtimi i kërkesave
5. Të ndryshme

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

*Burim Gërguri*  
Burim Gërguri





Dalës-izlazna

Nr. 1-06  
Br.

Data 23.01.2019  
Datum

OBILIĆ-OBILIĆ



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.26.12.2018, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm janë këta anëtarë:** Burim Gërguri, Labinot Mirena, Enver Gashi, Agon Mjekiqi, Qëndresa Dubova, Florije Jashari, Shaip Paloja, Linda Sadiku, Fatos Kurshumlija, Fatmir Bektashi, Arbnore Nasufi, Lulzim Sadiku, Hysni Mjeku, Samire Berisha, Xhezide Dragusha, Armend Rushiti, Nora Preniqi, Dragan Dancetovic, Nazmi Gashi dhe Slavisa Spasic

**Të pranishmit tjerë:** Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, Slavisa Jakovljevic, Nënkyetar i Komunës për komunitete, Arben Berisha, drejtor i DPUKP-së, Burim Ismaili, drejtor i DI-së, Zarife Behluli, drejtoreshë e DEFZH, Agim Spahiu, drejtor i DKA-së, Ibush Mjekiqi, drejtor i DSHMS-së, Fitore Hashani, drejtoreshë e DMM-së, Avdyl Mustafa, kryesues i Komitetit për komunitete, Ganimete Aliu, zyrtare për barazi gjinore, Dritëro Kelmendi, mësimsdhënës në shkollën "Ibrahim Rugova", Valmir Sadiku, (IZHL), përf. e OSBE-së dhe përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

### REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Raporti i punës së Kuvendit komunal për vitin 2018
4. Raporti i performancës Komunale për vitin 2017
5. Raporti vjetor i Zyres së Personelit për vitin 2017
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

**Burim Gërguri** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Aprovohet njëzërit rendi i ditës i cekur më lartë.

**1.Pika e parë e rendit të ditës –**

**Mungoi:** Aziz Bici me arsye

**2.Pika e dytë e rendit të ditës –**

**Shaip Paloja** – Paraqiti vërejtje në ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar për shkak të një gabimi teknik në diskutimin e tij rreth Këshillave të fshatrave, ku në vend të fjalës "Nënkyetari" duhet të jetë fjala "Kryetari".

**Dragan Dancetovic** – Procesverbali është mjaft voluminoz dhe përmbajtësor dhe këtë duhet lavdëruar. Kur është fjala për këtë procesverbal, do të doja që me këtë rast ta lusja kolegun Lulzim Sadiku ta tërheqë deklaratën e tij në kuadër të pikës së pestë të rendit të ditës, që gjendet në faqen 14, të procesverbalit kur ka folur për Ambulancën në Babin Most. Juve z.kryesues ju falenderoj për komentimin që e dhatë pas

diskutimit. Mendoj se nuk do të duhej të merremi gjatë me këtë dhe të polemizojmë rreth kësaj, por më e drejta do të ishte dhe në frymën e tolerancës dhe politikisht e mençur do të ishte e drejtë që kolegu Lulzim Sadiku ta tërheqë këtë deklaratë.

**Burim Gërguri** – Është çështje e asambleistëve se si shprehen, është e drejtë e tyre me mendue dhe unë s'mund ta detyroj askend. Besoj se fjalë fyerje apo ofendim s'ka pasë, por është mendim politik. Kjo nuk ka të bëjë me procesverbalin fare dhe në pikën "Të ndryshme" mund ta sqaroni këtë çështje.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me me 18 vota "Për" dhe 1 votë "Kundër" e aprovuan ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar me vërejtjen e cekur më lartë.

### **3.Pika e tretë e rendit të ditës –**

**Burim Gërguri** – Lexon raportin e punës të Kuvendit komunal për vitin 2018 dhe falenderoi kryesuesin e Komitetit për komunitete, i cili ka pasë një bashkëpunim të jashtëzakonshëm me zyren e Kryetarit, Drejtoritë dhe me komunitetet prej nga vjen.

**Nazmi Gashi** - Kërkon një varëse për robe në sallën e Kuvendit komunal dhe pajisjen me ID kartela për anëtarët e Kuvendit komunal.

### **4.Pika e katërt e rendit të ditës -**

**Burim Gërguri** – Lexon raportin e performancës komunale për vitin 2017.

**Kryetari** – Nëse, ka pyetje nga anëtarët e Kuvendit, atëherë mund të përgjegjet kordinatorja.

### **5.Pika e pestë e rendit të ditës –**

**Burim Gërguri** – Lexon raportin vjetor të Zyres së Personelit për vitin 2017.

### **6.Pika e gjashtë e rendit të ditës –**

**Burim Gërguri** – Lexon kërkesën nga DPUKP për lirim nga taksat administrative komunale dhe kryerjen e shpenzimeve te noteri për qytetarët të cilët pronat e tyre i kalojnë në pronësi të Komunës.

**Kryetari** – Ne shpeshherë po hasim në disa rrugë për shkak të rrethanave të krijuara dhe kemi rastin kur një pjesë e rrugëve janë me hapësirë jo të mjaftueshme. Mirëpo, me vullnetin e mirë vetë qytetarët ofrojnë mundësi që të zgjerohet rruga. Ne e kemi praktikue dhe e praktikojmë si formë mbledhjen e nënshkrimeve nga ata qytetarë dhe tash ato prona që i kanë ofrue qytetarët falas në shërbim për Komunën ne dojmë me i bë prona komunale. Ne kemi mendu dhe kishte me qenë mirë që në këtë rast të lirohen nga taksat administrative edhe rastet sociale, te marrja e lejes për ndërtim me i lirue si dhe rastet e zhvendosjes Hade, Shipitullë, që është praktikue më heret.

**Shaip Paloja** – Unë kam qenë prezentë në mbledhjen e KPF-së dhe mendoj se secili qytetarë i cili mendon që pronën e vet në njëfarë forme me falë, me dhënë në shërbim publik ose me ia dhënë Komunës, duhet me përshëndet. Atë ditë e ka arsyetu drejtori dhe më ka ardhë shumë mirë që së paku ata njerëz që e falin pronën e tyre në shërbim të qytetarëve tjerë, duhet t'ju lehtësohen obligimet administrative. Mendoj se ne si grup do ta përkrahim dhe e përshëndesim.

**Nazmi Gashi** – Më vjen pak e çuditshme qysh ka mund me ndodhë kjo deri tash edhe me të dhënë dikush diçka dhe me të dhënë prapë mjete. Ndoshta, pak sistemi administrativ mos ka pasë ndonjë ngatërrim përndryshe gjithçka që merret, çdo pjesë prej diçkafit që merret krijohet historia e rastit. Mos të ndodhë ne me ia marrë atij 2 ari, ai me i pasë aty 2 ha në bllok, e me thënë hiqmi tash krejtë, megjithatë është sistemi administrativ që i përcjellë gjërat, ëshë kadastri, janë matjet. Mendoj se kjo çështje është dashur moti me qenë e rregulluar dhe nëse rregullohet ashtu si duhet aëherë, ne nuk do të bëjmë pengesa.

**Lulzim Sadiku** - Nëse, lagjja "Sadiku" ka një rrugë dhe vërtetë lidhet e gjithë lagjja, mund ta kthen si pronë komunale që shërbimet ti merrë dhe mos të paguhet takes, apo një diçka tjetër. Mua më pëlqej si ide shumë e qëlluar dmth hyn nën patronatin e Kryetarit të Komunës, që nuk paguhet taksat dhe e mirëmbajnë gjatë dimrit. Unë konkretisht kështu e kuptova, më pëlqeu dhe jam pro kësaj kërkesë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal unanimisht morën këtë:

## **V E N D I M**

**Aprovohet kërkesa nga DPUKP, për lirim nga taksat administrative komunale si dhe kryerjen e shpenzimeve te noteri për qytetarët të cilët dëshirojnë që pronat e tyre të kalojnë në pronësi të Komunës, me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm.**

**Burim Gërguri** – Lexon kërkesën nga DPUKP, për lirim nga pagesa e taksave administrative për rastet sociale dhe për donatorë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal unanimitisht morën këtë:

#### V E N D I M

**Aprovohet kërkesa nga DPUKP, për lirim nga pagesa e taksave administrative për pagesën e lejes ndërtimore për të gjithë përfituesit e skemës së ndihmës sociale (të cilët paraqesin kartelën e ndihmës sociale të vlefshme) dhe për donatorë.**

**Burim Gërguri** – Lexon kërkesën nga DPUKP për aprovim të taksës administrative të MMPH-së.

**Arben Berisha** – Unë kërkesën e kam sqaruar edhe në mbledhjen e KPF-së, dhe kjo është kërkesa jonë që monitorohet nga Ministria, që nuk lejon me ndodhë diçka me futë taksë më të lartë, ose më të ulët. Mirëpo, është kalkulimi që e kam bashkangjitur në dokumentacion, thuhet gjithçka është e paraparë me ligj dhe ne vetëm ashtu kemi vazhduar. Ne më heret nuk kemi pasë taksë administrative për leje rrërimi që duhet me qenë në bazë të Udhëzimeve administrative, që edhe këtë e kemi përfshirë. Unë kam menduar që tarifa të jetë më e lartë, por Ministria e ka kthyer 2 herë sepse nuk lejohet dhe ne jemi në harmoni me ligjin.

**Nazmi Gashi** – E kam lexuar dhe s'më ka pëlqyer fare sepse edhe Ligji për Obiliqin na mundëson që disa gjëra duhet me i liruar. Prandaj, jo me ngritë taksën drejtor por mundou me i mbajtur këto që i kemi ose me na i zvogluar ende.

**Burim Gërguri** – Taksa, 4 centë është ngritur, por kur bëhet me ligj të legalizimit ne do ta shqyrtojmë.

**Arben Berisha** – Sqaron se taksa ka qenë 1 euro e 91 centë, ndërsa u bë 1 euro e 95 centë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal unanimitisht morën këtë:

#### V E N D I M

**Aprovohet kërkesa e DPUKP-së, për taksën administrative e aprovuar nga MMPH-ja, sipas Udhëzimit administrativ nr.02/2018, në mënyrë që të fillojnë këto taksa të aplikohen në fillim të vitit 2019.**

**Burim Gërguri** – Lexon kërkesën nga Blerim Krasniqi, nga fshati Begaj, Komuna e Vushtrrisë për ndërrimin e destinimit të tokës, nga toka bujqësore në tokë ndërtimore.

**Kryetari** – Ju e dini se njëherë këta kanë bërë kërkesë për leje të përhershme, por nuk është e drejtë e Kuvendit dhe me ligj lejohet deri në 10 vite, nëse është ndërtim i lehtë me konstruksion. Kompania "Cao berto" është e njohur për të gjithë ne si biznes dhe nëse, krijohen mundësitë për vende pune ju vlerësoni dhe vendimin tuaj ne do ta respektojmë.

**Shaip Paloja** – Kjo kompani është e dëshmuar në Kosovë dhe sipas kërkesës ai parashehë deri në 60 punëtorë ti punësoj dhe mua më intereson vetëm se a është në kundërshtim me ligjin shëndërimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Nëse, nuk bjen në kundërshtim me ligjin mendoj se është një ofertë e mirë.

**Kryetari** – Sqaron se ne kemi të drejtë të japim vetëm leje të përkohshme.

**Arben Berisha** – E tha edhe Kryetari, këtu është fjala për leje të përkohshme për periudhën 10 vjeçare me material montues, që nuk është i ngurtë. Nëse, ne ju ndihmojmë atyre, ata na ndihmojnë neve në punësim. Starti është të punësohen 60 punëtorë, por është edhe shkolla profesionale, kështu që deri në 300 punëtorë kanë me gjetë veten aty.

**Burim Gërguri** – Është fatbardhësi që gjendemi në mesin e 2 Komunave, më të mëdha e kryeqytetit dhe e kemi përballë Vushtrrinë, kështu që shumica e bizneseve iu kanë drejtue Komunës së Obiliqit. Nëse, mundemi sa më shumë me krijue alternativë me u zhvillue, mendoj se kjo është forma e vetme e zhvillimit duke e zvogluar papunësinë dhe duke e rritë mirëqenien e qytetarëve.

**Lulzim Sadiku** – Unë jam pro të gjithë atyre, që vijnë me investue në Komunën e Obiliqit, po na e sjellin numrin 60 të punësimit, por nëse i marrin vetëm 6 jam pro. Këtu, po kërkohet për 10 vjet, por nëse ka mundësi ligjore kërkoj të bëhet për 20 vjet. Ne po e shohim Komunën e Fushë Kosovës, që e kemi shumë afër të gjitha bizneset po shkojnë atje, prandaj nëse mundemi jemi pro të gjitha kërkesave që vijnë për biznes.

**Armend Rushiti** – Kërkesën e kam lexuar dhe kam debatuar në mbledhjen e KPF-së. Ky pronar ka bërë kërkesë edhe në Ministrinë e bujqësisë, përmes Drejtorisë së bujqësisë të Komunës së Obiliqit dhe kjo

kërkesë në Ministri të bujqësisë është refuzue. Arsyet dihen sepse nuk lejohet shëndrimi i tokës të klasës së 3 dhe 4 dmth nuk ka të drejtë ta bëjë Kuvendi komunal. Kjo kërkesë është refuzue në gusht të këtij viti, që me siguri e dini edhe ju. Atë ditë kryesues, të pyeta se a ka fillue ndërtimi i këtij objekti, ju thatë jo por objekti është duke u ndërtuar. Kjo është krejtë e palogjikshme, me thënë diçka të pavërtetë. Ju e dini shumë mirë se objekti është duke u ndërtue dhe askush nuk mundet me na hedhë hi syve sepse jemi të kësaj Komune dhe gjërat merren vesh. Prandaj, kjo kërkesë është e kundërligjshme sepse ne si Kuvend komunal s'mundemi me bë legjitime këtë kërkesë dhe nëse e shkelim ligjin atëherë, ne mundemi me i ndihmue këtij pronari.

**Burim Gërguri** – Sqaron se nëse, në atë kohë ka qenë kërkesë e përhershme tash, është e përkohshme dhe ne nuk e shkelim ligjin, por edhe Ministria në këto momente është duke na monitorue që nuk na lejon me gabue. Ideja është që ne të jemi në shërbim të qytetarëve, t'ju krijojmë mundësi bizneseve që me ndihmue këtë komunitet.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 15 vota “Për” 1 votë “Kundër” dhe 1 votë “Abstenim” morën këtë:

## V E N D I M

**Aprovohet kërkesa nga Blerim Krasniqi, nga fshati Begaj Komuna e Vushtrrisë pronar i kompanisë “Berto” Sh.p.k me seli në Vushtrri për ndërrimin e destinimit të tokës nga toka bujqësore në tokë ndërtimore.**

**Burim Gërguri** – Ju njoftoj se kërkesa nga qytetarët e lagjes “Mirena” fshati Hade për shtruarjen e rrugës me zhavorr ia kemi dërgue DSHPE-së, për trajtim.

**Hysni Mjeku** – Pyet se a ka mundësi në lagjen “Imeraj” në Sibofc, të intervenohet.

**Kryetari** – Sqaron se për situata emergjente duhet me gjetë forma me ndihmue, ndërsa sa i përket pjesës tjetër infrastruktura, shërbimet publike pothuajse gjithë buxheti është përmbyllë dhe nuk ka mundësi përveç situatave emergjente me nxjerr ndonjë vendim të veçantë. Rreth infrastrukturës këtë vit zhvillimet që kanë ndodhë jemi mbetë prapa, janë shpallë shumë vonë, disa kontrata duhet të vazhdojnë edhe në vitin tjetër. Poashtu, janë 3 parqe duke u ndërtue dhe priten me kontratë të vazhdohen në vitin tjetër. Studimi i fizibilitetit është shpallë për nxemjen qëndrore, që është lajm i mirë edhe për juve sepse është përzgjedhë operatori dhe pritet të nënshkruhet edhe kontrata. Sa i përket përgatitjes së projekteve, ne po mundohemi me i bë sa më shumë paramasa dhe paralogari, kështu në start të vitit planifikojmë të shpallet një operatorë për punimin e projekteve detale. Lajm i mirë është se buxheti në leximin e parë ka kalue dhe ne kemi bërë kërkesa për ngritje të kapaciteteve humane për punëtorë administrativ më shumë. Sipas informatave që i kemi prej grupit punues të Komisionit parlamentar 15 vende janë lirue. Lajm tjetër i mirë është për bizneset sepse një zonë industriale, që është shpallë kaherë që ka qenë problem i vazhdueshëm i zhvillimit të punimeve në atë zonë për shkak të Ibër Lepencit, është tejkalue. Të gjithë ju që vlerësoni se ka dikush interes për biznes dhe me krijue vende të reja pune për qytetarët tonë janë të mirëseardhur. Në procedim të dytë janë edhe Ligji për pagat, që pritet të fillon në bazë të katalogut edhe nivelizimi i pagave. Poashtu, edhe për anëtarë të kuvendit komunal do të ketë një ngritje mjaft të madhe. Pastaj, është çështja e ligjit për dhënien e tokave në shfrytëzim, që do ti shkurtoj procedurat për shkak të bizneseve dhe shumë e shumë ligje tjera. Mbi të gjitha Ligji i Obiliqit, po bëhet realitet dhe Obiliqi për kokë banori do të jetë ndër Komunat më të fuqishme në ballkan. Edhe për komunitetin sërbë është lajm i mirë sepse me z.Slavisa, ia kemi bërë kërkesën Ministrisë së zhvillimit ekonomik dhe KEK-ut, për pronën për ndërtimin e shkollës së re të ish shkolla teknike. Prona është aprovue dhe pritet shumë shpejt të bartet në pronësi të Komunës. BE-ja e ka sjellë një donacion që besoj se do të jetë një nga projektet e ardhshme. Meqë, jemi në fundvit shfrytëzoj rastin t'ju uroj të gjitha festat duke ju dëshiruar shëndet dhe të gjitha të mirat në familje.

### 7. Pika e shtatë e rendit të ditës -

**Hysni Mjeku** – Pyeti projektet që kanë vazhdue, a do të barten në vitin e ardhshëm.

**Kryetari** – Përgjegjet se ne do ta bëjmë një raport dhe besoj se në raportin e përmbylljes do ti keni të gjitha sqarimet për të gjitha Drejtoritë. Me keqardhje e them se buxhetin e kemi pasë të alokuar në shkurt

sa i përket investimeve kapitale dhe fatkeqësisht projektet janë shtye deri në vjeshtë dhe si pasojë e shtyrjes së projekteve nuk janë arritë me u përmbyllë të gjitha, kemi qenë në mëshirën e kohës. Në këtë drejtim do të ketë pasoja, kontratat janë të nënshkruara dhe planet dinamike janë përmbyllë për shkak të kushteve atmosferike. Rruga juaj te shkolla, pastaj në Mazgit kanë mbetë për 1 ditë i zuri bora dhe nuk mbërritëm me krye, për shkak të reshjeve. Ne kemi arritë me shtye një mundësi plus rreth Shtëpisë së kulturës, janë ndarë edhe 200,000 euro për këtë vit. Mirëpo, më së keqi jemi në infrastrukturë te lagjia Hade, te sheshi do të kemi humbje dhe te 5 projektet e rrugëve, por detalisht raportet do ti sjellim në shkurt edhe kur ka ndodhë alokimi i buxhetit, kur janë nënshkruar memorandumet, kur ka fillue ekzekutimi i tyre dhe pse kanë mbetë të papërfunduara.

**Lulzim Sadiku** – Te çështja e Hades, u përmendë lagjia jonë rr.”Imeri” vërtetë ka nevojë një intervenim shumë të shpejtë, nëse flitet për 2,3 kamiona, por nëse s’ka mundësi sinqerisht vetë do ta shtroj vetëm ma jepni numrin e atyre, që ju keni kontakt me ata sepse nuk di se kush bartë zhavorr. Këtu, flitet për 2 kamiona zhavorr dhe është një intervenim i domosdoshëm.

**Burim Gërguri** – Unë e kam kërkesën e muajit të kaluar që është trajtue në KPF dhe Kuvend, që nuk kemi marrë ndonjë përgjegje. Fjala është për kërkesën nga kompania CNC, Sh.pk, pronar Selman Kadriu për shëndrrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore

**Nazmi Gashi** – Pyeti sa është sipërfaqja e tokës.

**Burim Gërguri** – Përgjegjet 33 ari.

**Kryetari** – Sqaron se ju e dini që për kategorinë e 5 dhe 6 të tokës, është e drejtë e Kuvendit. Unë vijë vet nga biznesi dhe jam gëzue shumë kur është bërë zhblllokimi i zonës industriale sepse do të ketë mundësi për krijimin e bizneseve të reja. Në këtë rast për kategorinë e 5 dhe 6, ka të drejtë Kuvendi komunal me bë shëndrrimin e pronës. Meqë, mund të jetë mundësi e mirë për neve, ju vlerësoni por është mirë me u mundue me i përkrahë bizneset.

**Lulzim Sadiku** – Unë në mbledhjen e fundit kam qenë pro dhe e kam pasë një kërkesë që atë me obligue sepse makina CNC lidhet me shkollën e mesme teknike, që konkretisht është pronë private të kthehet nga ajo bujqësore në ndërtimore. Unë kisha kërkuë nga ai që një pjesë e nxënësve të profilit të makinerisë ta kryejnë pjesën praktike, përndryshe jam pro kësaj kërkesë.

**Dragan Dancetovic** - Unë në fillim të mbledhjes së sotme e lavdërova procesverbalin nga mbledhja e kaluar dhe gjatë miratimit isha ”i përmbajtur” dhe më duket se gabimisht u konstatua se isha ”kundër”. Tjetra, që dua të them është se meqë është fundi i vitit kalndarik, do të doja që të gjithëve t’jua uroj Vitin e Ri dhe Festat Ortodokse, atyre që festojnë dhe juve dhe familjeve tuaja t’ju dëshiroj çdë të mirë dhe suksese në jetën e mëtejme.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 18 vota “Për” morën këtë:

#### V E N D I M

**Aprovohet kërkesa nga kompania “CNC NOLL” Sh.p.k pronar Selman Kadriu për shëndrrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore, parcela me nr 769-0, lloji i shfrytëzimit, arë e klasës së 5-të, në sipërfaqe prej 3309 m2 ZK Milloshevë.**

**Shaip Paloja** – Ne si subjekti i dytë në këtë Kuvend komunal, që e kemi thënë edhe më heret dhe prapë po e përsëriti nuk e kemi përfaqësimin e duhur në Komitetet obligative. Tash, kur i kemi parasysh subjektet siç është LB-ja, me 2 anëtarë e përfaqësuar në 2 Komitete, ligji e thotë se përfaqësimi në Komitetet obligative, duhet të jetë ashtu si janë të përfaqësuar edhe në Kuvendin komunal. Mendoj dhe kërkoj që në këtë seancë të bëhet rishqyrtimi dhe të bëhet përmirësimi i atij gabimi. Kërkoj që ne të kemi përfaqësimin tonë, që e parashehë ligji në 2 Komitetet obligative.

**Enver Gashi** – Edhe ne si grup më i madh parlamentar e përkrahim këtë ide dhe propozojmë që 1 anëtar të vjen nga LDK-ja, në një Komitet, ndërsa në Komitetin tjetër anëtar tjetër të vjen nga Aleanca. Ne e kemi propozimin për z.Labinot Mirena, në KPF ndërsa LDK-ja, le të jepë një emër nga gjinia femërore.

**Lulzim Sadiku** – Komitetet kur janë formue, unë kam qenë pro që LDK-ja, të ketë anëtar ndërsa, sot kërkoj mos të hudhet në votim meqë, jemi pranë festave të prolongohet për seancën tjetër.

**Fatmir Bekteshi** – Propozoj që të shkoj gjini për gjini 2 anëtarë ti ketë LDK-ja, e jo Aleanca bile edhe ushtrues detyre me na favorizue pak neve, sepse jemi subjekti i dytë.

**Enver Gashi** – Pajtohemi që LDK-ja, ti merrë 2 vende.

**Burim Gërguri** – Tash, ne kemi një plotësim ndryshim të Komiteteve obligative dhe është procedurë e rregullave të punës së Kuvendit që të votohet.

**Armend Rushiti** – Tashmë, po shihet gjithçka nëse, jeni të uritur për 50 euro edhe LDK-ja për Vitin e Rindmth nuk është problem kjo punë zgjidhet shumë lehtë. Ne edhe më heret kemi qenë në qeverisjen komunale dhe i dijmë arsyet pse jemi largue dmth për neve, kjo është plotësisht e padrejtë ndërsa ju i keni numrat dhe është mirë me shpallë zyrtarisht këtë farë aleance dhe me vazhdue, kështu që veç suksese.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota “Për” 3 vota “Kundër dhe 1 votë “Abstenim” morën këtë:

#### V E N D I M

**Që të inicohet plotësimi dhe ndryshimi i Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për komunitete.**

**Shaip Paloja** – Propozon që në KPF të jetë anëtar Fatos Kurshumlija, ndërsa në Komitetin për komunitete të jetë Arbnore Nasufi.

**Slavisa Spasic** – Pyeti se a po rritet numri i anëtarëve, apo po ndryshohet.

**Burim Gërguri** – Përgjegjet se numri s’mund të rritet sepse është e rregulluar me Udhëzim administrativ vetëm po bëhet ndërrimi i anëtarëve.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 16 vota “Për” 1 votë “Kundër dhe 1 votë “Abstenim” morën këtë:

#### V E N D I M

**Bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Komitetit për Politikë dhe Financa me anëtarin Fatos Kurshumliu (LDK) në vend të anëtarit Armend Rushiti (LB).**

Dhe

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 15 vota “Për” 3 vota “Kundër” morën këtë:

#### V E N D I M

**Bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Komitetit për komunitete, me anëtaren Arbnora Nasufi (LDK) në vend të anëtares Nora Preniqi (LB).**

**Kryetari** – Kemi edhe Komisionin vlerësues për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim meqë, ka ndryshime në Ekzekutiv në vend të Përparim Klinakut, ne propozojmë të jetë Arben Berisha dhe të zëvendësohet edhe Armend Rushiti me një nga anëtarët që ju na jepni nga LDK-ja.

**Armend Rushiti** – Tash, keni marrë drejtim tjetër që edhe me më thirrë Fatmir, për mua nuk është çudi dhe Kryetar faleminderit shumë për të gjitha deri më tash, vetëm suksese.

**Kryetari** – Pyeti a nuk po jepë dorëheqje.

**Armend Rushiti** - Përgjegjet jo dorëheqje nuk japë kurrë absolutisht.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 13 vota “Për” 1 votë “Kundër” dhe 3 vota “Abstenim” morën këtë:

#### V E N D I M

**Bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Komisionit vlerësues për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim me anëtarin Arben Berisha, në vend të anëtarit Përparim Klinaku.**

**Shaip Paloja** – Unë kam një pyetje për drejtorin e shëndetësisë, se në QKMF në Obiliq nuk e di pse nuk ka reagenca për analiza dhe këtë e kam vërtetuar vetë. Fjala është për bilurbinat, që unë vetë kam hasë në këtë problem dhe më thanë qe 2 vite, nuk ka reagenca për me mund me u bë këto analiza. Në mungesë të reagencave nuk bëhen këto analiza dhe disa tjera, prandaj kërkoj sqarim prej drejtorit.

**Florije Jashari** – Sqaron se është e vërtetë se reagenca nuk ka pasë qe një kohë dhe varet prej doktoreshës përkatëse, a mundet me i bë apo jo analizat.

**Shaip Paloja** – Mua personeli më ka thënë se i bëjmë, por qe 2 vite e më tepër s’kemi reagenca dhe unë personalisht privat i kam bërë dikund 10 euro, ishte vlere e atyre analizave.

**Ibush Mjekiqi** – Unë personalisht në emrin tim dhe të Drejtorisë mund të përgjegjem se nuk mund të ndodhë që 2 vite, që s’kemi reagenca nëse Drejtoria nuk ka pasë kërkesë për këtë punë. Para 1 viti, ne e kemi marrë aparatën biokimik, por ende nuk është në funksion për shkak të një kontrate që e kemi me furnizim dhe në vitin 2019 ajo do të funksionalizohet. Kjo, nuk është që 2 vite por ka shumë vite që nuk bëhet bilurbina në QKMF dhe ne i bëjmë të gjitha ato analiza të cilat janë përshkruara me Udhëzimin administrativ që i bëjnë QKMF-të. Ne do të bëjmë përpjekje maksimale si Drejtori, që ta futim në funksion aparatën biokimik, të cilin e kemi donacion nga Ministria e shëndetësisë. Ju informoj se punëtorët shëndetësorë sot janë në grevë 24 orëshe, për shkak të pagave dhe mund të merren vetëm shërbimet e domosdoshme për rastet urgjente.

**Lulzim Sadiku** – Unë të gjelbërimi kam qenë kritik dhe po e shohë se po bëhet renovimi, apo po mbjellen të reja. Ju njoftoj se të bagrenat e butë ju kisha lutë të mos i krasitni sepse bagreni i butë nuk krasitet, as qershia nga se janë dy lloje pemësh që prishen. Unë po e shohë se jeni duke u anagzhuë dhe kontribue në rrugën kryesore shumë, por pyetne edhe dikend që është ekspertë sepse sa e di unë ai nuk krasitet.

**Kryetari** – Sqaron se ne e kemi kompaninë që merret me mirëmbajtje dhe seriozisht nuk e di se a duhet me i krasitë apo jo. Në këtë vit është fat i mirë se janë mbjellë mbi 1,000 dhe tash pasi kemi fillue me bë buxhet më shumë planifikimet janë që trupat e drunjve të jenë shumë të zhvilluar ose më të vjetër në vite, se sa që kanë qenë më heret. Unë më heret e përmenda studimin e fizibilitetit sa i përket ambientit dhe tash po thojnë pasi nuk janë LB-ja, se krejtë mjetet po shkojnë në infrastrukturë. Konsideroj se buxheti më i madh është në infrastrukturë, por e kemi bërë bashkë. Përcaktimi të ambientit është laborator që do të merret me matjen e tokës, ajrit, ujit dhe zhurmës, një laborator për të cilin janë ndarë 350,000 euro. Pastaj për nxemjen qëndrore janë 530,000 euro, në total për fillimin e projektit të kogjenerimit. Poashtu, janë edhe 600,000 euro për parqe, mbjellje të drunjëve, shëndrrimin e zonave të reja të gjelbërta, që është një shumë mjaft e mirë e mjeteve. Shpresojmë se edhe të nxemja qëndrore do të kemi donacione, por do të kemi donacione edhe në krijimin e zonave të reja të gjelbërta prej Ministrive të ndryshme. Mendoj se Obiliqi do ta ketë një të ardhme shumë të mirë, i ka 6,250,000 euro investime kapitale duke bërë dallimin me vitin 2014, ose 2015 dhe 2019-2021 delë se rreth 21 milion do të jenë investime kapitale dhe subvencione në Komunën tonë. Unë do të jem shumë bashkëpunues me të gjithë juve, me shoqërinë civile dhe me çdo qytetar që e ka qëllimin e mirë dhe mendon për të mirën e Obiliqit.

**Armend Rushiti** – Kryetar, sa i përket LB-së, që e përmende LB-ja, gjithmonë ka qenë transparente edhe ka me qenë. Ju e dini shumë mirë, e din arsyen pse jemi largue, kështu që nuk shohë kurgjë të keqe sepse LB-ja, gjithmonë ka mendue për transparencën në të gjitha fushat ku veprojmë.

**Kryetari** - Unë thashë se do ta përpilojmë raportin i cili do të jetë raport zyrtar i argumentuar në fakte dhe dëshmi që Komuna, i ka si institucion ligjor.

**Fatmir Bekteshi** – Gjatë kryerjes së kanalizimit në fshatin Breznicë dhe unë e di se ajo kompani nuk ka marrë pëlqimin e Komunës, për prerjen e asfaltit. Rruga Breznicë-Kozaricë, ka qenë shumë e keqe, por tash edhe më katastrofë sepse nuk ka marrë pëlqim. Mendoj se duhet të paktën zhavorr me dërgue nëse, ka mundësi edhe pse rruga është mbyllë dhe është në gjendje shumë të keqe.

**Hysni Mjeku** – Ne i kemi zgjedhë 2 Komisione, për themelimin e Këshillave të fshatrave dhe nuk jemi takuar fare, që së paku është dashur një takim ta kemi me anëtarët e Komisionit në mënyrë që ti marrim disa objektiva, të dijmë se nga të orientohemi. Unë e di se është fundi i vitit, por nuk është vonë prej janarit e tutje.

**Burim Gërguri** – Sqaron se ne i kemi dorëzuar vendimet në MAPL për ligjshmërinë e tyre, por ende nuk na janë kthyer. Në momentin që na kthehen, Komisioni që është për hartimin e planit të punës të Kuvendit, bashkarisht me Kryetarin kemi me bë planin e punës dhe në kuadër të planit të punës hyn zgjedhja e Këshillave të fshatrave.

**Armend Rushiti** – Unë e kam një pyetje për drejtorin Arben Berisha, lidhur me një pronë në fshatin Bakshi, e cila është shpallë si zonë me interes publik dhe drejtori ka mbetë me më kthye përgjegje se deri ku kanë shkue procedurat. Njëkohësisht në këtë pyetje mund të përgjegjet edhe Kryetari.

**Kryetari** - Përgjegjet se faktikisht si procedurë me pronën, që është provue të ndërrohet me pëlqimin e pronarit dhe me kërkesën e qytetarëve, ne e kemi bërë kërkesën në Ministri, por Ministria ka kërkuar që të bëjë vlerësimin. Ne jemi duke punuar në këtë drejtim në shumë fusha edhe te objekti që ka qenë pjesë e Shtëpisë së kulturës, pastaj kjo pjesa tjetër. Poashtu, ju njoftoj se kemi bisedue edhe me postën rreth mundësisë së zhvendosjes së postës nga ajo zonë, kështu që nuk di se kemi marrë ndonjë përgjegje ende prej Komisioneve të Ministrisë. Mirëpo, në momentin që marrim përgjegje sigurisht se ua kthejmë dhe vazhdojmë me procedurën e mëtutjeshme. Nëse, don me u arsyeu pse ose nëse mendon se ka teke, inate nuk është duke u bërë ajo punë, ju e dini se deri para 2 muajve, ka qenë Nënkryetar Ajë Berisha dhe ka qenë i informuar me procedurat dhe në vazhdimësi kemi kërkuar prej Ministrisë, që me u zgjidhë ai problem. Tash, në fundvit ju po i shihni edhe vetë angazhimet e Ministrive të ndryshme, e sidomos Ministria e financave, shumë pak ka bërë lëvizje. Ne i kemi parashtruar kërkesat edhe për zonat tjera me bë vlerësimin, por ende nuk kemi ndonjë përgjegje. Unë e di se kjo është në të mirën e qytetarëve dhe ne kemi me bë përpjekje me krye.

**Armend Rushiti** – Qe 8,9 muaj mos me marrë përgjegje, kjo është absurde.

**Lulzim Sadiku** – Për një rrugë që i lidhë 4 Komunat, kisha dashur që nëse bën me ia dhënë dikujt në nivel qendror dhe me u shtrë ajo rrugë.

**Kryetari** – Sa i përket projektit ideor e ka bërë Drenasi dhe meqë, njëherë është mbyllë si procedurë që fatkeqësisht në aplikim jemi 5 Komuna, Mitrovica, Vushtrria, Obiliqi, Skënderaj dhe Drenasi. Çuditërisht Obiliqit dhe Vushtrisë iu ka kthye negative ndërsa, Drenasit, Skënderajit dhe Mitrovicës nuk iu ka kthye. Ne jemi duke e shqyrtuar prapë si mundësi dhe besoj se nga vijat e bashkëfinancimit, do të ulemi përsëri për me trajtue si problem sepse është një rrugë e mirë që i lidhë. Saktësisht pak e njohë atë territor dhe me emërime nuk di me tregue, por do t'ia kërkoj Drenasit dhe në mbledhjen e ardhshme mundemi me pasë të saktë. Edhe disa rrugë tjera janë në proces të rikategorizimit, është rr.Obiliq-Grabocë, rr.Dardhishtë-Fushë Kosovë, rr.Breznicë-Kozaricë-Vushtrri. Poashtu, është duke u punuar në drejtimin që rruga prej Prishtine, që hyn tash nga Barileva deri në Breznicë, e njehta me vazhdue deri në Shalë.

**Dritëro Kelmendi**, mësimdhënës në shkollën "Ibrahim Rugova" – Ne kemi formuar një grup të vullnetarëve të nxënësve dhe kemi marrë iniciativë për shpërndarjen e ndihmave për fëmijët që kanë nevojë. Ne kemi qfaqë 2 filma në shkollën tonë dhe të hollat nga biletat kemi mendue me i shfrytëzue për blerjen e dhuratave. Kësaj iniciative i janë bashkangjitur edhe shumë biznese, por ideja është që edhe Komuna të na bashkangjitet. Ne kemi mendue me qenë 100 pako, dhurata për Vitin e Ri.

**Fatmir Bektashi** – Pyeti sa ka qenë çmimi i biletës.

**Dritëro Kelmendi** - Përgjegjet 1 euro.

**Burim Gërguri** – Kjo është një iniciativë e qëlluar dhe ne e përkrahim me mundësinë që e kemi.

**Nazmi Gashi** – Ne gjatë vitit kemi bërë shumë punë bashkë dhe mendoj se është mirë që edhe Vitin e Ri ta festojmë bashkë.


**Burim Gërguri** – Unë i falenderoj të gjithë anëtarët e Kuvendit komunal për kontributin e dhënë, vlerësimin dhe kritikën sepse vërtetë ka qenë një vit i gjatë i punëve me sfida dhe marrjen e shumë vendimeve, ndër të cilët më i rëndësishmi ishte aprovimi dhe funksionalizimi i Ligjit për Obiliqin. Uroj që viti 2019 të jetë më i shëndetshëm, më i begatshëm për të gjithë ju dhe neve.

**Mbledhja përfundoi në ora 12:00**

**Bashk.prof.për punë të KK**

  
Azize Zeneli

**Kryesuesi i Kuvendit komunal**

  
Burim Gërguri

